



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.115, datë 18.07.2024

PËR
“CAKTIMIN E ZONJËS DENISA PERDJA NË DETYRËN E PROKURORIT
NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË, NËPËRMJET
PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE”

Mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës, nenin 90, pika 2 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenin 41 dhe 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164, pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 44 dhe 45 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin e zonjës Denisa Perdja në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në pozicionin vakant Nr. 1 shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.13, datë 16.02.2024.
2. Marrëdhëniet financiare që lidhen me pagën dhe përfitimet e tjera do të përballohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë duke filluar nga data 02.09.2024.
3. Relacioni i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Denisa Perdja, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.
5. Ky vendim hyn në fuqi më 18.07.2024 dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 18.07.2024.



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda




ANËTAR
Moisi Duda



ANËTAR
Arta Mandro



ANËTAR
Vatë Staka



ANËTAR
Ledina Riza



ANËTAR
Olger Eminaj

